



Tirana International Airport
Nënë Tereza



EKSTRAKT NGA
RAPORTI
VJETOR I TIA-s
2011

Tirana International Airport SHPK
Aerporti Ndërkombëtar i Tiranës
Nënë Tereza
Godina e Administratës, Rinas
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
E-Mail: info@tirana-airport.com
Web site: www.tirana-airport.com



Përmbledhje mbi 2011

mars 2011

Në përputhje me objektivat e saj për të rritur cilësinë, dhe ku është e mundur ofrimin e shërbimeve të reja, TIA implementoi sistemin e ri për ndjekjen e fluturimeve në kohë reale, në faqen e saj të internetit, www.tirana-airport.com.

prill 2011

Simulimi i një Ushrtimi i Emergjence, i përshkallëzuar në të gjitha detajet u zhvillua me sukses në aeroport. Procedurat dhe proceset e dokumentuara në TIA u testuan në bashkëpunim me organet e emergjencës shqiptare.

qershor 2011

Bazuar në përgjegjësitë e saj sociale, TIA organizoi me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit (DBM) 2011 aktivitete që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit mbi mjedisin, të tilla si trajnime për mësuesit, si dhe aktiviteteve në terren (grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme, vizitë në kompaninë e riciklimit të mbeturinave, etj).

nëntor 2011

Një ngjarje e rëndësishme u zhvillua gjatë këtij muaji ku kompania ajrore Belle Air filloi të ofrojë vetë shëbinin e pasagjerëve në tokë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Të dhëna mbi trafikun ajror

Statistika	Zhvillimet e trafikut		
	Viti 2011	Viti 2010	Δ %
Pasagjerë	1,817,073	1,536,822	18.2%
ATM - të	11,494	10,384	10.7%
Kargo (tn)	2,290	1,946	17.6%

TIA shënoi një rritje pozitive dyshifrore për sa i përket zhvillimit të trafikut për vitin 2011, duke arritur në 18.2% rritje në numrin e pasagjerëve, kryesisht si rrjedhojë e liberalizimit të vizave. Italia mbetet nxitësi kryesor i kësaj rritjeje. Belleair vazhdon të ketë pjesën më të madhe të tregut në TIA me 46.1 për qind të udhëtarëve. Albanian Airlines dhe Alitalia mbuluan 8.5 për qind të tregut secila. Albanian Airlines iu pezulluan fluturimet më 10/11/2011.

Lëvizjet e trafikut ajror (ATM-të) treguan një rritje pozitive prej 10.7 për qind për vitin 2011. Frekuencat rritura duke u bazuar mbi pikun e periudhës së verës dhe ofrimi i destinacioneve të reja kontribuan në një zhvillimin të përgjithshëm pozitiv.

Trafiku i kargos paraqiti një rritje prej 17.6 për qind për vitin 2011 krahasuar me vitin 2010. Rritja kryesisht erdhi si rrjedhojë e ofrimit të fluturimeve të përkushtuara për kargon dhe rritja e shërbimeve të postës çarter.

Zhvillimet e aeroportit

Regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme në Krujë ka lëshuar për TIA-n certifikata pronësie për objektet e mëposhtme:

1. Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujrave të zeza
2. Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve
3. Rehabilitimi zonës së pajisjeve ajrore
4. Zgjerimi i apronit të ri

Projekte të ndërtimit janë zbatuar në TIA si vijon:

- Ndërtimi i linjës së re të shkarkimit të ujërave të shiut, për lumin Terkuza (brenda dhe jashtë zonës së konçesionit).
- Ndërtimi I rrugës së re të jashtme, në zonën perëndimore të konçesionit

Mjedisi, Shëndeti, Siguria dhe Cilësia

Gjatë vitit 2011, TIA ka arritur objektivat e saj dhe objektivat që lidhen me cilësinë, mjedisin, shëndetin dhe sigurinë si dhe përgjegjësinë sociale. Në këtë drejtim TIA vazhdoi punën e saj në drejtim të ndërgjegjësimit dhe sqarimit të përgjegjësive të punonjësve dhe partnerëve të saj të biznesit në menaxhimin e efekteve mbi mjedisin, shëndetin dhe sigurinë.

TIA në bashkëpunim me aeroportet e grupit HOCHTIEF filluan një projekt që synon optimizimin e efikasitetit të energjisë, uljen e kostove të energjisë dhe zhvillimin e veprimtarive që synojnë kursimin e energjisë në mënyrë të dukshme. Në këtë drejtim një Plan Veprimi është përgatitur, që përmban masat e kursimit të energjisë në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata.

Me qëllim për të përmbushur përgjegjësitë e saj sociale, TIA ka vazhduar promovimin e iniciativave të gjelbra në lidhje me aspektet mjedisore dhe rritjes së ndërgjegjësimit kundrejt tij. Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit TIA organizoi një aktivitet dy-ditor: Trajnimi i mësuesve të shkollave përreth zonës së aeroportit nga trajnues profesional ishte i përqendruar në lëndën edukuese mbi mjedisin të prezantuar rishtazi si dhe shpërndarjen e librave mjedisore tek mësuesit, fletore për student, etj; një vizitë e fëmijëve në ambientet e TIA-s të grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimit të tyre nga kompania e kontraktuar, si dhe një orë e hapur me ta, e fokusuar në riciklimin e mbeturinave në mënyrë që të promovohet sa më shumë të jetë e mundur koncepti Ripërdor – Redukto – Riciklo.

Studimi vjetor i kënaqësisë konsumatore në terminalin e pasagjerëve dhe të kargos është kryer edhe në vitin 2011, duke rezultuar me një kënaqësi konsumatore të vlerësuarat në përgjithësi në nivelet më të larta.

Një vështrim më i hollësishëm mbi performancën e TIA-s dhe arritjet e saj publikohet në Buletinin Mjedisor dhe Social i cili gjendet pranë zyrave të TIA-s ose nëpërmjet faqes së internetit të TIA-s: www.tirana-airport.com.



Performanca Financiare

Si rrjedhojë e trafikut në rritje TIA ka arritur një xhiro prej 33.9 milionë euro në vitin financiar 2011. Gjatë gjithë këtij viti TIA është ka operuar në pajtueshmëri me të gjitha konventat e nevojshme financiare.

Si dhe në vitet e mëparshme, pasqyrat financiare të TIA-s për vitin janë mbyllur më 31 dhjetor 2011 të përgatitura në përputhje me SNRF, janë audituar nga një auditor i pavarur i cili lëshoi një opinion të pa kualifikuar për vitin 2011.

Në bazë të zhvillimit pozitiv të trafikut përgjatë vitit 2011 si rrjedhojë e liberalizimit të vizave dhe pritshmëritë në përgjithësi të ulëta përsa i përket ekonomisë shqiptare për vitin 2012, TIA parashikon një zhvillim të moderuar për vitin 2012.

Tiranë, prill 2012

